

MEHMET I. ÇELIKU

ROTACIZMI NË TË FOLMET KALIMTARE TË GJUHËS SHQIPE

§ 1. Në këtë punim 1) do të trajtojmë shkurtazi dy çështje kryesore: I) Së pari, do të qartësojmë nocionin «**e folme kalimtare**» ashtu siç e kuptojmë ne; II) Së dyti, do të vështrojmë në vija të trasha fenomenin e rotacizmit në të folmet kalimtare të gjuhës shqipe.

Burimet nga i kemi marrë materialet, që bahen objekt studimi, janë këto: 1) Kemi shfrytëzue materialet tona të mbledhuna në krahinat **Dumre, Shpat, Darsi e Peqinit, Bregdet i Poshtëm i Kavajës**²⁾; disa nga materialet tona të mbledhuna në Tiranë e Elbasan nga disa subjekte sulovarë për të folmen e Sulovës dhe disa materiale të mbledhuna për Polisin në Elbasan; 2) Kemi shfrytëzue materialet që na ofroi Q. Haxhihasani për të folmet e **Vërcës, Bërzeshtës, Polisit, Rajcës** dhe **Sulovës**³⁾. 3) Kemi të dhana nga J. Gjinari për «**Të folmet e Myzeqesë**»⁴⁾ dhe nga F. Leka për të folmen e **Mokrrës**.⁵⁾

* * *

I. MBI NOCIONIN «E FOLME KALIMTARE»

§ 2. Historiku i trajtimit të problemit.

Asht ba zakon që dy dialektet e gjuhës shoibe, gegënishtja dhe toskënishtja, të ndahen nga lumi Shkumbin. Megjithatë, ky lumë nuk asht një kufi i premë por i përfaqërt.

Se Shkumbini përban një kufi aproksimativ e deri diku konvencional, asht thanë shumë kohë përpara. Kështu **D. Kamarda** pothuajse para njëqind vjetësh shënonte: «Ndarja e dy dialekteve gjatë lumit sigurisht nuk është aqë e prerë sa të dy këta gjatë një copë vendi më këtë anë

1) Ky punim që u hartue në tetor 1951 asht kumtue (po në këtë kohë) në një sesion shkencor të fakultetit Histori-Filologji.

2) Materialet ne i kemi mbledhë në ekspedita, që janë organizue në kohë të ndryshme dhe deri më sot (d.m.th. deri në botimin e këtij artikulli) na kemi ba objekt studimi të hollësishëm disa prej tyre.

3) **Q. Haxhihasani**: 1) «**Anketa Gjuhësore**» Volumi 53/ Arkivi i Folklorit 2) «**Një vështrim mbi të folmen e krahinës së Sulovës**» Bulet. për Shkencat Shoqërore, II, 1955.

4) **J. Gjinari**: «**Të folmet e Myzeqesë**», Bulet. Univ. Shtet. të Tiranës Nr. 4/1958.

5) **F. Leka**, materiale të mbledhuna në ekspeditë leksikologjike.

dhe m'at anë të lumit të mos jenë përzier edhe të mos jenë njësuar; në n.ënyrë që atje, d.m.th. në qendër të Shqipërisë, të mos jetojë një idiomë e tillë, që nga një farë pikëpamje mund të quhej e përbashkët» (Mendimin e tij D. Kamarda e mbështet në të dhanat e **Hahnit, Albaneseche Studien**, Jena 1854)⁶⁾. E me të vërtetë një «idiomë e tillë e përbashkët» e njësimit të dy dialekteve ekziston, por, tue e saktësue tezën e Kamardës, duhet thanë se kjo «idiomë» nuk shtrihet «më kët anë e më at anë të lumit», por kryesisht në arën e majtë të lumit.

Gjithashtu Gj. Pekmezi jep këto informata për të folmet që përdoren në arën e majtë të Shkumbinit⁷⁾: «në Babje, Polis dhe në Shpat vokalet nazale i flasin si Elbasani» (f. 4): «Me këtë rast po përmendim se ku fillon -r- intervokaliqe për -n-, që asht gjaja ma karakteristike e toskënishtes: në Vërcë dhe në Mokërr» (f. 5): Edhe ma poshtë: «Tue udhëtue për Elbasan konstatova se po kaloje në një krahinë, e cila ishte krejt geqe, ndonse rruga shkonte në jugë të Shkumbinit. Këtu më erdhi ndër mend me ba hetime se deri ku arrinte në jugë të lumit influenza e gegënishtes... Së pari, kalova në krahinën e Shpatit, ... Këtu si edhe në krahinën e Polisit, në lindje të tij, flitet një gjuhë si ajo e Elbasanit; vendasit e quejshin vehten gegë. Vokalet nazale... natyrisht edhe -n- intervokaliqe ishin të gjitha si në Elbasan». «Edhe këtu (asht fjala për të folmen e Vërcës, M.Ç.) vokalet nazale janë shumë ma të dobëta... bile përzihen edhe fjalë me -r- intervokaliqe, gja që asht e zakonëshme në Mokërr, në vazhdimin e Bërzeshtës (ky asht një dialekt toskënisht, por me vokale nazale). Në Bërzeshtë mora rrugën kah verilindja për më dalë përsëri në xhadet. Këtu kufinin në mes toskënishtes dhe gegënishtes e formon fusha e Domosdovës, p.sh. Kododeshi asht krejt toskënisht d.m.th. (katund që ka një të folme toske, M.Ç). Interestant asht që ne këtu gjejmë përsëri mjaft të fortë kuantitetin dhe akcentin muzikor, që konstatuem në gegënishte. Rrypi në bregun perëndimor të liqenit të Ohrit, p.sh. Hudunishtit, Mëmëlishtit, natyrisht edhe Pogradeci vetë janë toskë» (f. 12-13).

Fakti që Gj. Pekmezi ka konstatue në të majtë të lumit të folme që kanë tipare të dialektit gegë, asht sa i drejtë aqë edhe me randësi, por megjithatë këto informacione të hollësishme përmbajnë një varg pasaktësish: 1) -R- intervokaliqe nuk fillon në Vërcë dhe në Mokërr; 2) Krahina (e Shpatit, Polisit), ku ka kalue autori i informatave, nuk asht «krejt gegë» megjithëse i njejtë autor ma poshtë ban një pohim kontradiktor kur thotë se hetonte «se deri ku arrinte në jugë të lumit influenza e gegënishtes»; 3) Në Shpat edhe në Polis nuk flitet një gjuhë si ajo e Elbasanit; këtu -n- intervokaliqe nuk asht si në Elbasan (ma hollësisht gjendjen e n-së intervokaliqe në këto të folme do ta shofim ma poshtë).

Tue folë në një mënyrë pak a shumë të përgjithëshme për afrimin e dy dialekteve të shqipes, N. Resuli thotë: «trajtat tepër të ashpërta e të vrazhdëta të gegërishtes së veriut dhe ato tepër «të qullëta» të toskërishtes së jugës, vijnë e pastrohen e ëmbëlsohen në ujërat e Shkumbinit».⁸⁾

6) D. Camarda, «Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese»: Livorno 1864.

7) Gj. Pekmezi, «Raportë provizore të Komisionit Ballkanik» f. 4, dhe 12-13; (Arkivi i Institutit të Historisë e Gjuhësisë).

8) N. Resuli, «Gegërishtja apo toskërishtja?» «Shkëndija», Nr. 2/ 1940/ f. 18.

Ma hollësisht mbi afrimin e dy dialekteve të shqipes ndalet **Q. Haxhihasani**, 1) Së pari, autori nënvizon me të drejtë «karakterin kapërximtar, ndërlihdës të të folmeve krahinore të Shqipnisë së Mesme».

2) Së dyti, autori rithekson me të drejtë se lumi Shkumbin, si kufi tradicional që ndan dy dialektet e shqipes, «asht një kufi i vumë» «grosso modo».

3) Së treti, **Q. Haxhihasani** vëren me të drejtë se të folmet e Bërzeshtës, Polisit, Shpatit, Vërçës, Sulovës, Dumresë etj.» shërbejnë si urë kalimi për nëndialektet oë fliten në të djathtë të lumit Shkumbin dhe nëndialektet jugore që fliten në jugë të tyne» (f. 148).

4) Së fundi, **Q. Haxhihasani** shpjegon edhe arësyet e afrimit të dy dialekteve të shqipes siç janë: «ndikimi i rrethanave gjeografike, ekonomike dhe shoqërore (takimi i popullsisë gege e toske në qendra tregtare të përbashkëta etj.)».

Megjithatë i duhen ba disa vërejtje pohimeve dhe konkluzioneve të **Q. Haxhihasanit**:

1) Së pari, në pohimet e autorit nuk del i qartë nocioni «të folme kalimtare»; nuk merret vesh se ç'kupton autori me «veçori tranzicioni», të cilat sipas tij «janë karakteristike për shumë të folme të krahinave të Shqipnisë së Mesme». Madje autori karakterin kapërximtar, ndërlihdës të të folmeve që janë në të majtë të lumit, e barazon me karakterin kapërximtar të të folmeve që shtrihen në të djathtë të lumit; ma konkretisht: karakter kapërximtar (kalimtar), sipas autorit, kanë si «të folmet e Çermenikës, të Malësisë së Tiranës dhe të Durrësit që shërbejnë si ura kalimi për të folmen e Dibrës, Matit e Krujës nga një anë dhe ato të krahut të përtejme të Shkumbinit nga ana tjetër, ashtu edhe të folmet e Bërzeshtës, Polisit, Shpatit, Vërçës, Sulovës, Dumresë për nëndialektet që fliten në të djathtë të lumit Shkumbin dhe nëndialektet jugore që fliten në jugë të tyne».

2) Së dyti, autori (siç e pohon edhe vetë) nuk jep asnjë «tipar të përgjithshëm, element të përbashkët të grupit të të folmeve ndërmjetëse midis dy dialekteve themelore», që do të shërbente si kriter për ta quejtë ose jo një të folme kalimtare; gjithashtu nuk përcakton kufijtë gjeografikë dhe përhapjen e këtyne të folmeve.

3) Së fundi, disa konkluzione të autorit, sipas nesh, ose nuk janë të sakta ose janë të shpejtueme: a) konkluzioni se «Ndryshimet midis dy dialekteve këtu (asht fjala për të folmen e Sulovës) dobësohen, trajtat e tyne karakteristike humbin tiparet diferencuese...», nuk na duket i saktë; b) Mendimi se nën ndikimin e gegënishtes dyzanor: hi **ua** i toskënishtes në zonën veriore të Sulovës monotongëzohet në **u**, na duket i papranueshëm; c) Pohimi se «nazalizmi, që, përveç disa rasteve sporadike, nuk vihet re në të folmen e kësaj krahine (asht fjala për krahinën e Sulovës, M.Ç.), nuk na duket i saktë (sidomos për pjesën veriore, «Sulovën e rpome»); ç) Pohimet «se elemente të gegënishtes **hyjnë** thellë edhe përtej Shkumbinit, deri në Devoll e Holtë, madje deri në të djathtë të këtij lumi», ose konkluzioni se «e folmja e Sulovës, në shtresën e saj themelore, është një e folme, që ruen karakteristikat kryesore të toskënishtes», na duken të shpejtueme (meqenëse elementet e gegënishtes në të majtë të lumit mund të mos jenë elemente të futun, por të vendit).

§ 3. Mendimi ynë mbi nocionin «e folme kalimtare».

Nocionin «e folme kalimtare» ne nuk e përdorim në kuptimin ma të gjanë të fjalës, përkundrazi këtij nocioni ne i japim një domethanje konkrete e të përcaktueme: Për mendimin tonë, kemi një të folme kalimtare atëhere kur bashkëjetojnë në të njëjtën të folme të paktën një tipar i randësishëm i gegënishtes dhe një tipar i randësishëm i toskënishtes; dhe nuk janë kalimtare ato të folme, ku vërehen përzimje të tipareve të tjera të dorës së dytë veriore e jugore.

Le të flasim ma konkretisht: dihet se nazalizmi asht një karakteristikë themelore e dialektit gegë, ndërsa rotacizmi i n-së intervokalike asht një karakteristikë themelore e dialektit toskë; pra, nëqoftëse bashkëjetojnë nazaliteti i gegënishtes dhe rotacizmi i toskënishtes në një të folme të vetme, atëhere kjo e folme asht kalimtare. Ekzistenca e këtyne dy tipareve në të njëjtën të folme njikohësisht, besojmë të shërbejë në dialektologji si kriter për përfshimjen ose jo të një të folmeje të dhanë në të folmet kalimtare.

Tue u mbështetë në këte kriter, ne konstatojmë një brez të tanë të folmesh kalimtare. Ky brez të folmesh kalimtare të gjuhës shqipe shtrihet kryesisht në anën e majtë të Shkumbinit. Në këtë zonë përfshihen të folmet e këtyne krahinave: **Myzeqeja veriore** (fusha e Lushnjes edhe Karatopraku), **Darsia e Peqinit, Dumreja, Vërça, Sulova, Shpati** (i parë edhe i dytë), **Polisi, Bërzështa, Domosdova** (Rajcë), **Mokrra**.

Si shifet, të folmet kalimtare, dmth. të folmet që përbajnë si të thuesh një farë kalimi nga dialekti verior gegë në atë të jugut toskë, shtrihen në një brez relativisht të gjanë, që ka këta kufij:

Kufini verior i tyne, që asht njikohësisht edhe kufini jugor i dialektit verior gegë, asht lumi Shkumbin. Kufini jugor i të folmeve kalimtare, që asht njikohësisht edhe kufini verior i dialektit jugor toskë, asht një kufi me ma shumë zikzake: Ana perëndimore e këtij brezi si kufi jugor ka «Dellin», që e mbajnë si shtratin e vjetër të lumit Devoll. Pika ma e avancueme këtu asht katundi Gur. Por në këte zonë midis Gurit dhe Shkumbinit duhet të përjashtohen disa katunde (si p.sh. Divjaka, Kulari), popullsia e të cilëve përbahet nga «lalë», që janë të krishtenë e që nuk kanë një të folme kalimtare. Pjesa qëndrore e këtij brezi vjen e zgjanohet ma tepër tue kapërxye përtej Devollit: Sulova shkon deri në Tomorricë dhe në Nahije të Beratit. Si pika ma të avancueme të Sulovës së sipërme (që asht pjesa ma jugore e Sulovës) janë Bregasi dhe Kushova. Vërçra shtrihet deri në Opar (J.) dhe Gorë (J.-L.) edhe ka si pikë ma të avancueme Shënepremten. Me Gorën ndahet edhe Mokrra. Pikat ma të avancueme të Rajcës shkojnë deri në Urakë e Kododosh. Kufini jugor e lindor i brezit të të folmeve kalimtare mund të jepet edhe ma i detajuem.

Ndonji ishull të folmesh kalimtare ndodhet mbi kufinin natyral verior të këtij brezi. E pikërisht në rrjedhjen e poshtme të Shkumbinit, në anën e djathtë të lumit, nja katër katunde të Bregdetit të Poshtëm të Kavajës (Rrethi, Grethi, Boshtova, Spilleja) kanë gjithashtu një të folme kalimtare. Kjo shpjegohet me faktin se mbartësit e kësaj të folmeje nuk janë autoktonë në vendin ku jetojnë sot, që asht në të vërtetë një zonë krejt gege; ata kanë ardhë në këto pika të banueshme relativisht vonë, nga Myzeqeja (Divjakë etj.)

Gjithashtu gjurma të elementeve toske vihen re edhe në ndonji vend tjetër sipër Shkumbinit; kështu p.sh. në Dragostujë, që gjindet në të djathtë të Shkumbinit dhe në lindje të Librazhdit¹⁰.

* * *

Në të gjithë brezin e të folmeve kalimtare, të cilit ne sapo i caktuem kufijtë në mënyrë të përafërt, gjithashtu edhe në ishujt e të folmeve kalimtare, që ndodhen mbi kufinin natyral verior të këtij brezi, bashkëjetojnë nazalizmi i gegënishtes edhe rotacizmi i toskënishtes.

Meqenëse për rotacizmin do të ndalemi ma poshtë, së pari, po japim material, që dëshmon se në të gjitha këto të folme gjejmë zanore nazale: **Shpat:** zâ, gjâ, hûj, trîra; **Vërrçë:** bâra, âsht, u âj, zâri,

râr, njâ; **Sulovë:** zan, kânk, duhân, ftônj, po vrâjtet, vëm, bôj, hârëm (hangrëm), ôsht; **Mokër:** ftiri (mutini), e bôra, tâmlat, e âmël, â°sht; **Polis:** prâj (pushoj), fullâz, tufâ, qêq, ulkôja, kërcîja, llâri (i dorës); **Domosdovë:** e bâora, gjâ° **Qukës:** âsht, bâte, rrajcârî; **Veriu i Myzeqesë:** i rân, njâri, qâ°n; zân, Bregdet i Poshtëm i Kavajës: thôjt, mullini, hû, ftôjt; **Dumre:** hû pë, kûj, të târa, vije, fullôz; **Darsi e Peqinit:** â, zêne, të târ; gjâ.

Nazalizmi i zanoreve nuk ka një shtrimje të barabartë dhe nuk asht i një shkalle intensiteti në të gjithë të folmet kalimtare. Në Sulovë, në Vërrçë, në Mokër, në Myzeqe nazaliteti i zanoreve të theksueme në ekstremet jugore të këtyre krahinave ose asht dobësue shumë ose në disa forma të caktueme fjalësh asht zhdukë fare.

Kështu në Bregas (nji nga katundet jugore të Sulovës) nazalitet të dukshëm ne konstatojmë vetëm në disa forma të caktueme fjalësh, p.sh. në formën e shumsit të emnave, që marrin mbaresat j (<nj) ose ij (<inj): frêj, hûj, thôj, kallij, draprij, gishtrij; në formën rasore të kallëzores së trajtës së shqueme të emnave mashkullorë, tema e të cilëve del

me -n: zân (zanin), kallîn (kallinin; por në formën përfaqësuese të emnores dhe në formëndryshimet që ajo pëson, zanorja e theksueme nuk dëgjohet nazale: kallî, kalliri). Përkundrazi në të njejtin katund e kanë humbë nazalitetin emnat mashkullorë, që sosnin me bashkëtingëllore nazale, por që tashti asht i rotacizueme: kërcu-ri, shulla°-ri, grur-i, etj.; krahaso p.sh. të folmen e Shpatit që asht nji e folme kalimtare ma veriore, ku zanoret e theksueme e rrejne nazalitetin rregullisht edhe atëhere kur bashkëtingëllorja n e temës rotacizohet: zâri, shullâri, kalostrâri, brîri, hîri, kushurîri, kërcûri, gjûri etj. Të folmet të cilat kanë zanore nazale vetëm në disa forma të caktueme fjalësh, ne do t'i konsiderojmë gjithashtu të folme kalimtare.

Përveç nazalizmit të gegënishtes që asht nji tipar mjaft i randësishtëm i të gjithë të folmeve gege, në të folmet kalimtare gjejmë edhe tipare të tjera të dialektit verior.

Tue mos dashë që të japim të gjitha tiparet gege, që kanë të folmet kalimtare, meqenëse kjo nuk asht detyrë e këtij punimi (në po merremi këtu vetëm me sqarimin e nocionit «e folme kalimtare»), po shtojmë edhe diçka për format e paskajores perifrastike gege me pjesëzën parafjalore me; që, megjithëse jo rëndom, takohen pothuëjse në të gjitha të folmet kalimtare: **Shpat:** baktija do ikin me kullot; i her tjetër shkûn me gjujtur; bugëlzën â ma kollaj me e thirr/ po â zafmet me e përzân; po

10) Q. Haxhihasani, «Nji vështrim... etj.», III/1955.

vjen me nej ktu; s'duhet me e prishur gjakun; Sulovë: kur fillon me u tha kalliri/ at-here do prer misri; do shkoj me punu; ku ke me shkur? — do shkoj me hapur një rrah; Bregdet i Poshtëm i Kavajës; jam nis me shkur un nuse; po nuk ishin lân dyr me hyr mrena n'pallat. . .; qe nisur me ardhur; Vërcë: me kundërshtuor do veç. . .; Bërzeshhtë: z'desh me ardhur; Veriu i Myzeqes: kishte xjerr ca dhi me shitur; Dumre: dalim me gjezdis; dulën me gjujtur; kishin nis me plasur; i ra me shkū.

Pra, përveç nazalitetit, që asht tipar i përgjithshëm i të folmeve kalimtare, në këto të folme gjejmë edhe shumë tipare të tjera të gegënishtes. Po kështu, përveç rotacizmit, që asht tipar i përgjithshëm i të folmeve kalimtare (për këte shif kapitullin vijues), në këto të folme takohen edhe shumë tipare të tjera të toskënishtes. Me një fjalë, nëqoftëse në një të folme bashkëjetojnë nazalizmi i gegënishtes dhe rotacizmi i toskënishtes, atëhere në këte të folme (që për ne asht një e folme kalimtare) ngërthehen ku ma shumë e ku ma pak edhe tipare të tjera të dialektit gegë e toskë.

Nga kjo del se të folmet kalimtare të gjuhës shqipe nuk kanë tipare kryesore të veta (nuk e kemi fjalën këtu për tiparet që kanë një randësi të dorës së dytë), por përgjithësisht disa tipare të këtyne të folmeve bashkohen me dialektin gegë e disa të tjera me dialektin toskë. Prandaj ndryshe nga dy dialektet e shqipes, d.m.th. ndryshe nga gegënishtja e toskënishtja, të folmet kalimtare nuk përmbajnë dot një dialekt më vehte. Si dialekti verior gegë ashtu edhe dialekti jugor toskë karakterizohen nga tiparet e tyre specifike gjuhësore, që janë karakteristike për të gjitha të folmet e këtij apo atij dialekti, ndërsa të folmet kalimtare nuk kanë asnjë tipar kryesor (me përjashtim të disave të dorës së dytë), në bazë të të cilit të dallohen këto të folme nga dy dialektet e shqipes, meqenëse këto të folme karakterizohen vetëm nga kombinimi i tipareve veriore e jugore. Një kombinim i tipareve veriore dhe jugore vërehet edhe në të folmet kalimtare të gjuhës ruse.¹¹⁾

§ 4. Mbi problemin e formimit të të folmeve kalimtare.

Një tjetër problem i randësishëm, që ka të bajë me të folmet kalimtare, asht problemi i formimit të secilës nga të folmet kalimtare. Në studimin e këtyne të folmeve, së pari, duhet të arrihet në përfundimin se janë apo jo kalimtare dhe, pastaj, duhet të studjohet procesi i formimit të secilës së folme kalimtare në veçanti. Duhet të studjohet në veçanti procesi i formimit të secilës të folme, sepse ne kemi të bajmë me raste të ndryshme të formimit të të folmeve kalimtare.

Dhe me të vërtetë në disa raste baza fillestare e të folmes ka qenë baza veriore, të cilës ma vonë i u mbishtresuen tipare jugore; përkundrazi, në raste të tjera baza fillestare ka qenë baza jugore, të cilës ma vonë i u mbishtresuen tipare veriore. Kështu deri tashti janë konstatue se disa nga këto të folme kalimtare janë të folme geqe në bazë dhe se elementet e toskënishtes, që ndeshen në këto, s'janë tjetër veçse influenza

11) P.S. Kuznjecov, «Russkaja dialektologija» Bot. III/ 1960 f. 154.

të vona të toskënishtes; të tilla janë p.sh. të folmet e Darsisë së Peqinit¹²⁾, Ekstremi verior i Myzeqesë¹³⁾ edhe Dumreja¹⁴⁾.

Kjo asht arësyeja që në konkluzionin e punimit tonë për të folmen e Dumresë ne jemi shprehë në këte mënyrë: «Tiparet dalluese të kësaj të folmeje dëshmojnë për faktin se këtu ne kemi të bajmë me një të folme geqe me influenca të ndieshme toske». Në këte konkluzion, për të folmen e Dumresë e të Darsisë së Peqinit, ne arritëm për arësyeën e thjeshtë se tiparet e toskënishtes në këto të folme janë të kufizueme, përkundrazi për të folmen kalimtare të Shpatit në punimin tonë mbi këte të folme¹⁵⁾ ne shprehemi kështu: «Pasi kemi ba ma se të qartë karakterin kalimtar të së folmes së Shpatit... ne nuk mund të arrijmë tashti për tashti në përfundimin se e folmja e Shpatit asht një e folme me një shtresë arkaike bazë veriore që ka një mbishtresë toske ose anasjelltas»; kemi qenë të rezervuem në këte konkluzion sepse «kjo e folme karakterizohet nga një kombinim mjaft i ndërlikuem i tipareve veriore e jugore» dhe nga ana tjetër ne mendojmë se gjetja e shtresës arkaike në të folme të tilla kalimtare, ku mpleksja e tipareve geqe e toske asht mjaft e komplikueme, mund të bahet vetëm atëhere kur këto të folme të jenë studjue që të gjitha.

Përkundrazi, e folmja e Bregdetit të Poshtëm të Kavajës asht një e folme kalimtare, që ka për bazë një shtresë toske, të cilës i janë mbishtresue tipare të gegënishtes (në këte konkluzion ne kemi arritë tue pasë për bazë edhe faktin se banorët e këtyne pikave të banueme janë jo autoktonë, të cilët patjetër kanë mbartë edhe shtresën toske). Po në këte konkluzion arrin Q. Haxhihasani për të folmen kalimtare të Sulovës: «E folmja e Sulovës, në shtresën e saj themelore është një e folme që ruen karakteristikat kryesore të toskënishtes»¹⁶⁾.

Të folmet kalimtare janë formue relativisht vonë. Faktori vendimtar që ndikon në formimin e këtyne të folmeve, asht pozita gjeografike që ka zona e të folmeve kalimtare. Kjo zonë ka një pozitë gjeografike ndërmjetëse, që zen vend midis truellit ku flitet gegënisht e truellit ku flitet toskënisht. Pozita gjeografike ndërmjetëse e kësaj zone ban të mundëshme që mbartësit e këtyne të folmeve të tregëtojnë njikohësisht në qendra ekonomike të ndryshme, banorët e të cilave flasin gegënisht ose toskënisht; qendra të tilla ekonomike janë: Elbasani, Peqini, Kavaja, Korça, Poradeci, Berati, Gramshi, Fieri e Lushnja. Pozita ndërmjetëse e kësaj zone ban të mundëshme që banorët e saj të bajnë krushqi njikohësisht me krahinat fqinjë geqe dhe toske. Së fundi, për formimin e të folmeve kalimtare duhet të merret në konsideratë shpërngulja e popullsisë nga një pikë e banueme toske në një truell gegë e anasjelltas dhe lëvizjet e mbrendëshme të popullsisë, d.m.th. lëvizjet, që bahen mbrenda për mbrenda pikave të banueme të kësaj zone.

12) M.I. Çeliku, «Skicë informative për të folmen e Peqinit» 1961, e pabotueme.

13) J. Gjinari, «Të folmet e Myzeqesë», Buletin i Universitetit Shtet. të Tiranës/ Nr. 4/ 1958.

14) M.I. Çeliku, «Vërejtje mbi të folmen e Dumresë» Buletin i Univ. Shtet. të Tiranës/ Nr. 2-3/ 1963.

15) M.I. Çeliku, «E folmja kalimtare e Shpatit» 1963 (e pabotueme).

16) Q. Haxhihasani, «Një vështrim mbi të folmen e krahinës së Sulovës» Buletin për Shkenc. Shoqërore/ III/1955.

II. NJË VËSHTRIM MBI ROTACIZMIN NË ZONAT KALIMTARE TË GJUHËS SHQIPE

§ 5. Pasi sqaruem nocionin «e folme kalimtare», ashtu siç e kuptojmë ne, do të ndalemi shkurtazi në përshkrimin e rotacizmit të **n-së** intervokaliqe në të gjithë zonën e të folmevet kalimtare. Siç dihet, fenomeni i rotacizmit të dialektit jugor asht tipar esencial, meqenëse ky fenomen nuk vërehet në gegënisht. Por po të themi që tani se rotacizmi asht dukuni jo vetëm e dialektit toskë por edhe e të folmeve kalimtare.

Megjithate, rotacizmin në të folmet kalimtare nuk e gjejmë të aplikuem njilloj si në toskënisht; pikërisht kjo e ban me interes përshkrimin nga pikpamja strukturore të këtij fenomeni.

Sikurse nazalizmi i gegënishtes nuk ka një shtrimje të barabartë në të gjithë të folmet kalimtare ashtu edhe rotacizmi i toskënishtes nuk shtrihet në mënyrë të barabartë në këto të folme. E kjo vihet re jo vetëm në shtrimjen gjeografike të fenomenit por edhe në shtrimjen në thellësi të tij.

§ 6. Shtrimja gjeografike e fenomenit të rotacizmit.

Këtu kemi parasysh përhapjen e fenomenit, d.m.th. në se rotacizmi vihet re në të gjitha zonat kalimtare apo jo. Materiali që kemi në dorë e ban të qartë se trajtat me rotacizimin e **-n-së** intervokaliqe takohen në të gjitha të folmet kalimtare tue përfshi edhe ato ma veriorët.

Pra, në kundërshtim me pohimin e Gj. Pekmezit se «**r**-ja intervokaliqe për **-n-**, që asht gjaja ma karakteristike e toskënishtes, fillon në Vërçë dhe në Mokërr», ne kemi konstatue se ky fenomen fillon në Bërzeshtë, Polis, Shpat, Dumre etj., krahina këto që shtrihen buzë Shkumbinit. Madje trajtat e rotacizueme në disa nga këto të folme janë mbizotnuese. Kështu p.sh. për të folmen kalimtare të Shpatit ne kemi në dorë mbi 90 fjalë (emna, mbiemna, përemna), tek të cilat vërehet rotacizmi; përkundrazi trajtat e parotacizueme janë shumë ma të pakta, gjithësej kemi takue këtu rreth 10 fjalë, që, megjithëse jo rregullisht, ruejnë nazalen **n**.

Zonat kalimtare, përsa i takon përhapjes së këtij fenomeni, mund t'i ndajmë në këto grupe:

1) **Zona ku fenomeni i rotacizmit jeton pothuajse plotësisht.** Këtij grupi i takojnë: **Shpati, Polisi, Bërzeshta, Vërça, Mokrra, V. i Myzeqesë; Domosdova.** Në këte grup përfshihet numri ma i madh i të folmeve kalimtare.

Në këte grup të folmesh kalimtare mbizotnojnë trajtat e rotacizueme. Megjithate në të folmet e këtij grupi kanë mbetë gjurma trajtash të parotacizueme, të cilat shpesh herë mund t'i konsiderosh ma tepër lëkundje subjektive se sa trajta të ligjëshme. Gjurmata e trajtave të parotacizueme nuk janë të barabarta në sasi në zonat e masipërme: Sa ma jugore të jetë zona kalimtare, aqë ma të pakta janë këto gjurma.

Po sjellim ma poshtë, sipas të folmeve të këtij grupi, vetëm disa shembuj nga shumë të mundëshëm për trajtat e rotacizueme dhe krahas këtyne disa nga shembujt e parotacizuem që ne kemi gjetë dhe që janë shumë ma të paktë në numër. Shembujt, që vijojnë, janë trajta fjalësh të rotacizueme, që u takojnë pjesëve të ndryshme të ligjëratës, ndër të cilat përfshihen edhe forma foljore:

Shpat: mul'iri, frëri, brirët, gjâra, atyre, bâra, bajtur; por: laknur, mretni, hyna, ardhun.

Sulovë: mulliri, huri, brirët, i tyne, hyri, lidhur; por: grūn, rona, grani, hyni¹⁷⁾

Vërçë: mulliri, rar (= rëra), pjepra, lakror, kputur; por: druni, boni.

Mokërr: mulliri shullôri, bôra, hyri, mordhur; por krahni, shullâni, mullini.

Domosdovë: ulliri, gruri, detra, hyra, lidhur, vdekur; por barna.

Veriu i Myzeqesë: ulliri, syri, gjôra, jâri, bari, pruri, zuri me shitur; por barna, rana, laknuri, zune.

Trajtat e parotacizueme janë jashtëzakonisht të pakta sidomos në **Mokërr të Sipërme, Domosdovë, Sulovë të Sipërme, Vërçë.**

2) **Zona ku trajtat e rotacizueme dhe trajtat e parotacizueme jetojnë në pothuajse barabar, në mënyrë paralele.** Në këte grup të folmesh kalimtare takohen me shumicë si trajtat e rotacizueme ashtu edhe ato të parotacizuemet. Këtij grupi i takojnë **Bregdeti i Poshtëm i Kavajës** dhe ndonji katund i veçantë afër zonave geqe, si asht p.sh. Babja (Në J. të Librazhdit por në të majtë të lumit)¹⁸⁾.

Kështu në Bregdetin e Poshtëm të Kavajës ne kemi ndëgjue, ndër të tjera, nga i njejtij subjekt ose nga subjekte të ndryshëm trajtat e maposhtëme paralele: **huri** dhe **hûni**, **themra** dhe **themna** (për femna), **lakruri** dhe **laknuri**, **turbullir** dhe **turbullin**, **gjilpër** dhe **gjilpan**, **toskëni** dhe **toskëri**, **njana** dhe **njoëri**, **hyni** dhe **hyri**, etj.

E njejtja lëkundëshmëni vërehet në këte të folme kalimtare në format e ndryshme fletive të së njejtës fjalë; edhe me të vërtetë një gja e tillë vërehet p.sh. në trajtën e shqueme ose të pashqueme të emnave: **gjarpën** dhe **gjarpri**; **drapër** dhe **drapni**; qére dhe qehja (=qehni).

Në katundin Babje ndëgjohen gjithashtu njikohësisht: **ul'iri ul'ini**, **ulliu**; **pjepra** dhe **borna**, **kroje** dhe **krorre**; **mulliri** dhe **mullini**, **frëri** dhe **frëni**, **pëni** dhe **përi**.

3) **Zona ku mbizotnojnë trajtat e parotacizueme.** Trajtat e rotacizueme në këte grup të folmesh kalimtare janë mjaft të kufizueme; megjithate, ato ndeshen ma shpesh nga trajtat e parotacizueme, që takohen në grupin e parë të të folmeve kalimtare.

Këtij grupi i takojnë të folmet, që kanë si shtresë bazë një shtresë të dukëshme geqe; këto të folme janë: **Darsia e Peqinit, Ekstremi verior i Myzeqesë, Dumreja** (tek.kjo e fundit përjashtojmë një tre katunde si Çerraga, Dëshiran, Dragot dhe ndonji lagje të veçantë të katundeve të tjera, të cilat banohen nga një popullsi jo autoktone).

Këtu po japim disa shembuj, që i janë nënshtrur fenomenit të rotacizmit; me këte material ne duem të mbështesim mendimin tonë se rotacizmi konstatohet si fenomen në të gjitha të folmet kalimtare:

Në Ekstremin verior të Myzeqesë: mulliri, hûri, bâra, me shitur;

Në Darsi të Peqinit: emër, pasuri, pleqëri, punrat, të târ, tallur, me fjetur.

Në Dumre: dimër, lakër, emra, këtyre, jâri, târ, myllur, dalur.

17) Shembujt, që kemi sjellë për trajtat e parotacizueme, nuk i takojnë të gjithë krahinës. Kështu p.sh. grun ndëgjohet në katundin Mollas të Sulovës; ro n dhe e gjon në Darzezë të Sulovës, etj.

18) Q. Haxhihasani, «Anketa Gjuhësore» (Arkivi i Folklorit).

Nga të tri ndamjet e masipërme të zonave kalimtare rezulton në lidhje me fenomenin e rotacizmit, së pari, se ky fenomen vërehet në të gjitha këto zona dhe, së dyti, se sa ma shumë të shkosh nga jugu, aqë ma mbizotnues bahet fenomeni.

§ 7. Shtrimja në thellësi e rotacizmit në të tri grupet e ma sipërme të të folmeve kalimtare.

Këtu do të vështrojmë se çfarë pjese të ligjëratës ose çfarë forma fjalësh përfshin rotacizmi në këto zona. Kë'e vështrim do ta bëjmë sipas grupeve të të folmeve kalimtare që dhamë në paragrafët e maparshëm.

Grupi i parë i të folmeve kalimtare.

Përsa i përket këtij grupi, që përfshinte zonat ku fenomeni jetonte pothuajse plotësisht, kuptohet se rotacizmi është i shtrimë përgjithësisht në të gjitha pjesët e ligjëratës edhe në të gjitha format e ndryshme të fjalëve, pra ai ka shtrimje pothuajse të plotë edhe në thellësi. Pra, në këte grup format mbizotnuese janë format me rotacizëm.

Megjithate, për këte grup të folmesh kalimtare duhen pa së pari format ma të përgjithëshme të fjalëve, ku vërehen trajta të pakta të parotacizueme (këtu po marrim anën e kundërt të fenomenit, kur ai nuk çfaqet për arsye se rastet janë shumë ma të kufizueme) dhe, së dyti, duhet vërejtë shtrimja analogjike e theksueme e disa morfemave të rotacizueme sipas një barazimi të madh analog të nazales **n** me **r**, gja kjo që nuk konstatohet as në të folmet toske të mirëfillta për rreth zonave kalimtare.

Të ndalemi në **çështjen e parë**: Fenomeni i kalimit të **n**-së intervokale në **-r**- nuk kryhet herë-herë në këto raste:

1) Nazalja **n**, që është një element i prapashtesës **-(ë) ni**, me të cilën formohen emna abstraktë e kolektivë, në disa raste ruhet e parotacizueme: **hajdutni, burrni, hasmëni, grani, mretni, zotni, besni, krushni**¹⁹.

2) Në disa raste ruhet i parotacizuem elementi i parë i morfemës formëformonjese **-na** ose nazalja **n** e mbaresën **-ën** të shumsit; këte e vërejmë sidomos në format e shumsit të emnave që sosin në temë me **r** (e cila tek emnat femnorë është ndodhë në pozicion fundor pas ranjes së ë-së fundore): **barna, farna, pëlhurna, qurna, vllëzn**. Besojmë që në ruajtjen e nazales **-n-** në disa nga këto raste të influencojnë arsye fonetike. Këto trajta ndëgjohen gjithandej, kështu p.sh. **barna** takohet e paprekun nga rotacizmi prej Myzeqesë (madje edhe në Divjakë) deri në Domosdovë.

Megjithate, në të shumtën e herëve elementi **-n-** i mbaresave **-na** edhe **ën** tek format e shumësit të emnave rotacizohet: **gishtra, mallra, shira, grekër, lanetër**.

3) Ka disa raste sporadike, kur nuk rotacizohet **-n-** ndërzanore, që është pjesë e temës së emnave ose mbiemrave. Në krahasim me rastet e

19) Shembujt, që po japim, nuk i takojnë që të gjithë çdo krahine të marrë veçmas. Këta shembuj ne i kemi grumbullue nga zona të ndryshme të të folmeve kalimtare e këtu po i karakterizojmë në një mënyrë të përgjithëshme sipas një tipari të jashtëm morfologjik.

rotacizmit të n-së së temës këto trajta takohen jashtëzakonisht trallë. Shtojmë gjithashtu se këto trajta janë mjaft të lëkundëshme (i njeiti subjekt, ose subjekte të ndryshëm shqiptojnë njëkohësisht të dy trajtat):

urdhën, gjylopân (në trajtën e shqueme **gjylopâra**), **krâhën, grûn, shëllin, pjepën, themën** (femër), **lakën, laknur** (dy fjalët e fundit shumë të përhapuna); Në Sulovë: **gûn, rona, i gjôn, Linas** (toponim), por nga ana tjetër **Çuk e Lirishtes**.

4) Interes paraqit fakti se në disa të folme të këtij grupi në formën e pashtjellun të pjesores, foljet që dalin në temë me zanore, nuk marrin prapashtesën formëformonjëse -r, që asht karakteristike për toskënishten, por ose marrin prapashtesën formëformonjëse -m²⁰, e cila, siç dihet, sot nuk takohet në të folmet toske, ose nuk marrin asnjë prapashtesë formëformonjëse, siç ndodh sot në shumë të folme të gegënishtes. Kjo asht karakteristike sidomos për të folmet kalimtare të Polisit, Bërzeshtës dhe Shpatit.

Kështu p.sh. shumica dërmuese e foljeve të zgjedhimit të parë²¹), në të gjithë Shpatin, del në pjesore me prapashtesën formëformonjëse -m (në dorë kemi mbi 96 raste formaçh të tilla), ndërsa pjesa tjetër e foljeve të këtij zgjedhimi në pjesore dalin ose pa morfema formëformonjëse, ose marrin prapashtesën -r (kemi takue në Shpat 17 raste me r); duhet theksue se në rastin e fundit prapashtesa r e toskënishtes i prapashtohet një teme, që sos me zanoren e gjatë **û** të përftueme nga monoftongëzimi i diftongut **ue** të gegënishtes; shembujt oë po siellim nuk janë vetëm të Shpatit: **pushûm, çûr, kujûm, marûm, shtrên^gum, pām, ngrîm, bām, hym; kulû, filû, bâ, vû; shlûr, afûr, msûr**.

Pjesoret që dalin me prapashtesën m e ruejnë -m- në edhe në të folme të tjera të këtij grupi sidomos kur janë të substantivume edhe të adjektivume; madje duhet theksue se ate e ruejnë edhe foljet, që dalin në temë me bashkëtingëllore; pra edhe foljet që e kanë marrë -m-në analogjikisht: **ar** e **punueme, e lame, e palām; e hapme, e preme; e arthmja, e dalmja, e hymja**.

Në i trajtuem këtu format e pjesoreve me prapashtesën formëformonjëse -m, sepse indirekt këto trajta kanë të bajnë me rotacizmin, përdërisa pjesorja e tipit **kujûm** i zen vendin pjesores së tipit **kujtuar** të jugut, që ndërtohet me prapashtesën formëformonjëse -r, e cila siç dihet nuk asht tjetër veçse shtrimje analogjike e prapashtesës së rotacizume -në të disa foljeve ma të vjetra (**lanë, etj.**).

5) Në raste shumë shumë të rralla mund të gjejmë në grupin e parë të të folmeve kalimtare prapashtesën -un me elementin e dytë të parotacizuem. Gjurma të tilla vërejmë ma tepër në të folmet ma veriore të këtij grupi. Këtu asht fjala për foljet, që dalin në temë me bashkëtingëllore: **mbledhun, myllun, ardhun**; aqë të rralla janë këto trajta, sa p.sh. në Shpat kemi takue gjithësej vetëm tre raste të variantit ma të vjetër -un: **humun, ardhun, prekun** e këto përkatësisht në katundet Zavalinë, Gjinar, Shtërmën.

6) Na kanë ra në sy disa raste fare të rralla të ruajtjes së -n-së ndërzanore në format foljore të aoristit dhe të mënyrës urdhënore:

20) A. Xhuvani «Studime Gjuhësore», faqe 203/ Autori e quen «mbaresë të vjetër».

21) Sipas klasifikimit që jep për tipet e zgjedhimeve Sh. Demiraj: «Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe» (dispensë), 1961.

hyni, boni (Sulovë), **prûna, zune, bane, lene**. Por format mbizotnuese janë ato me rotacizëm. Kështu në Shpat kemi ndëgjue: **agjërum, bari, ibzâra, gdhire, hyra, nxëri, pëgâri zûra, vûra; hÿr, lêre, zêre**

7) Së fundi, në kallëzoren e shqueme të emnave të tipit **fre-n-i**, etj. nuk hasen format analogjike **frerin**, por vetëm format **frën**; etj.: i vein **frë n** kalit, de kput **kallin, kushurin** e gjet n'shpi.

Pasi pamë rastet sporadike e jo konseguente të trajtave të parotacizueme, le të kalojmë në çështjen e **dytë**, dmth. le të shofim përgjithësimin analogjik të rotacizmit në të folmet kalimtare të këtij grupi.

Në këto të folme takojmë trajta të rotacizueme, që nuk gjinden në të folmet e mirëfillta toske, të cilat ndodhen pranë tyne. Këte shtrimje të rotacizmit në trajta të tilla ne e shofim si përgjithësim analogjik. Rastet ku vërehet përgjithësimi analogjik i rotacizmit ose i morfemave të rotacizueme toske, janë këto:

1) Nji nga çfaqjet kryesore të analogjisë në shtrimjen e fenomenit të rotacizmit janë **format e adaptimeve**,²²⁾ që konstatohen në të folmet kalimtare të këtij grupi.

Këto forma adaptimesh toskënishtja (të paktën ajo veriorja) nuk i njef, sepse historikisht në këto trajta nuk kanë qenë mundësitë për zhvillimin e rotacizmit.

Pra, këto forma të adaptueme përfaqësojnë në të vërtetë nji parregullsi të realizimit (zhvillimit) të fenomenit të rotacizmit, që njef përgjithësisht toskënishtja.

Format e adaptueme janë përfutue si rezultat të përziemjes edhe të barazimit analog, që ka vazhdue në radhën e tingujve **n, r**. Kështu në shumë nga këto të folme ndëgjohe si formë e rregullt për fjalën **kângë** apo **këngë** formacioni **kârk**;²³⁾ Këtu kemi të bajmë, pra, jo me rotacizimin e nji **-n-je** intervokalike, por me barazimin e **n-së**, që asht elementi i parë i nji grupi konsonantik, me konsonanten **r**; kuptohet pra se kjo fjalë, që nuk asht e rotacizueme as në toskënisht, asht përfutue si rezultat i nji adaptimi. Në këte mënyrë shpiegohet rotacizmi edhe në fjalën **gjirkall**, që ndëgjohe në Vërçë për **gjinkallë**²⁴⁾ etj.

Rezultatet e adaptimeve, që siç na tregon materiali nuk janë edhe aqë të rralla, ne do t'i ndajmë në disa kategori:

a) Fenomeni i rotacizmit asht zhvillue në disa fjalë, që nuk gjinden në fjalorin e mbarë toskënishtes ose të paktën në ate të të folmeve toske veriore, d.m.th. janë rotacizue fjalë të gegënishtes që kanë këto të folme: **kalastrâri** (kalastreni, zogëza); **rrër** (rrenë); edhe fjalët e tjera të prejardhuna prej saj: **rrerracak, rrërres** (= ai që rren), të **rrera** (= të pavërteta), **bzari** (= bzani), **tlyri** (tëlyeni; në Shpat edhe **tëlymi**), **trira** (= trina), **rreshtër, prûra** (solla).

b) Çfaqje të adaptimit ne shofim edhe në lamin e toponomastikës:

Rotacizohet në shumë raste nazalja **n** që asht elementi i dytë i prapshesës **-an** tek disa emna topikë: **Gjergjâr, Kuqar, Lleshar, Shigjar, Tregar** (krahaso emërtimet e këtyne katundeve të Shpatit në Elbasan: **Gjergjan, Lleshan, Kuqan, Shirgjan**).

22) Sipas kuptimit që i jep këtij termi **V.M. Zhirmunskij** në «**Njemeckaja Dialektologija**» f. 121.

23) Në Vërçë **Q. Haxhihasani** këte trajtë e ka gjetë si «trajtë të stabilizueme, që përdoret prej të gjithëve», «Anketa gjuhësore» volumni 53 (Instituti i Folklorit).

24) Kuptue gojarisht nga **P. Haxhillazi**.

c) Takohen të rotacizueme disa emna të tjerë topikë; toponimet emërtojnë vende të këtyne zonave ose të zonave të tjera: **Liqëri Valshit** (Zavalinë, Shpat); **Qaf e Liqërit** (kufi midis Shpatit e Polisit); **arat në liqer** (shpellë, Mokërr), **Liqere** (Laktesh, Mokërr; Por po në Mokërr, p.sh. në Rodokal, ndëgjohet toponimi **Bregu i Liqenit** ose po në Laktesh të Mokërrës ku ndëgjohej toponimi **Liqere**, ndëgjohet edhe toponimi **Bregu i Tërshanes**, tek i cili toponim nuk realizohet as rotacizmi i zakonshëm që njëj edhe toskënishtja e mirëfilltë).

Në Shpat për lumin Shkumbin dhe për qytetin e Tiranës kam ndëgjue emërtimet **Shkumivi** edhe **Tirara** (ndër të cilat e dyta takohet ma rrallë). Në Polis gjithashtu **Tirara** (por në trajtë të pashqueme **Tiran**).

c) Rotacizmin e vërejmë në prapashtesën **-an**, me të cilën formohen etnika: **matjar** (shpat); në Mokërr: **Selcër** (= Selcan), **plenishtër** (= plenishtan), **kalivaçër** (= kalivaçan), **kriçkovër** (= kriçkovan) etj.

d) Së fundi, përsa i përket adaptimeve në onomastikë duhet të përmendim se adaptimi vërehet edhe në antroponimikë. Kështu «Miraka, Elbasani etj. fisit të Tarushit i thonë Tanushi (pa rotacizëm); vetë ata e quejnë vetvehten Tarúsh»²⁵).

dh) Përsa i përket sistemit verbal kemi takue disa forma foljore, tek të cilat gjen shprehje adaptimi: **gdhire** (= gëdhine); **nxëri** (= nxeni); **-a e shiri** misrin? — nuk e ka shim, e xura (e nxuna, mësova vâra) (= vuna, por: ka vân).

Gjurma të këtij fenomeni kemi takue edhe në ndonji fjalë turke, e cila siç dihet asht marrë nga turqishtja shumë vonë, kur ligji i rotacizmit kishte pushue së vepruemi: Në Shpat ndëgjuem **legëri** (turqisht **legen**, ose sipas shqiptimit të Stambollit **lejen**).

Adaptimi vërehet si fenomen ma shpesh në **Polis, Vërçë, Mokërr, Shpat, Rajcë**.

Me interes asht barazimi analog jo vetëm midis **n** e **r-së** por edhe midis **t** e **r-së**; kështu p.sh. në Polis ndëgjohet: kush të **kër** (= të ketë) noj gja për ta than nje ta **thor** (= thotë); t'i **thor** Shabanit të vin te xhamia (= thotë). Besojmë të kemi këtu një analogji morfologjike (sipas të lërë, të zërë, etj.)

Një shtrimje analogjike e **r-së** mund të shifet edhe në shtesën fonetike të këtij tingulli, që konstatohet në disa fjalë (sidomos përpara **a** dhe **i** e në këte mënyrë sajohen kombinimet **-ra, -ri** tingëllisht të barabarta me morfemat: **-ra, -ri**): **krushqri, thatri, të lartra, përjashtra, tinras, etj.** Shtohet **r-ja** edhe në fjalë të tjera si këto: **qerpër** (qepër) **lap lëpjetre** (lëpjetë), **hurdhër** (hudhër), **urnaz** (unazë), **lesër** (lesë).

2) Nji çfaqje tjetër kryesore e analogjisë në shtrimjen e fenomenit të rotacizmit vërehet në trajtën e shqueme të disa emnave (përgjithësisht mashkullorë), të cilët dalin me temë në zanore të theksueme, dhe tek të cilët kemi një shtrimje analogjike të **r-së**. (analogji kjo që ka për bazë trajtat e tipit **hû-ri, ulli-ri**): **fmiri, kalamari, miri, nyri**. Aty këtu ndëgjoen edhe format e tjera të trajtës së shqueme: **nyja, miu**.

Për ne ka shtrimje analogjike të **r-së** edhe në trajta të tilla si **thuri** (m'dhem **thuri**, ose edhe **thuari**), **fturi** (edhe **ftuari**).

Nga ana tjetër edhe format e adaptimeve **dÿri, vergâri, liqëri** ose

të tjera raste, që shikuem në paragrafin e masipërm, në fund të fundit shpjegohen me modelet **hû-ri**, **ullî-ri**, që jetojnë në këto të folme.

Kemi takue raste të shtrimjes së bashkëtingëllores **-r** edhe në trajtën e pashqueme; pra, tema e disa emnave, që sosin me bashkëtingëllore ose me zanore të theksueme, zgjanohet me **-r**, që besojmë të jetë ose element i mbaresës së shumsit i mbetun edhe në njejës, ose element i njejsit të shquem **gjalmri**, në trajtën e pashqueme **gjalmër** (në shumës gjalmërit), **fëmiri** në shumës **fëmirët**.

3) Në të folmet kalimtare të këtij grupi bien në sy format emnore të shumsit, që ndërtohen me mbaresat e rotacizueme **-ra** dhe **-ër**; herëherë këto morfema formëformonjëse vërehen edhe në shumsa emnash, që toskët fqinjë përgjithësisht do t'i kishin si shumsa të tipeve të tjera: **lumra**, **copra**, **punra**, **gishtra**, **bokra**, **qilra**, **kofshtra**, **gjyshra**; shat > **shytër**, ujë > **hujqër**, lanetër, **qyqër**, tapallër, mijër, krua > **kror**, **kavajër** (Kavajrit fis në Seltë të Shpatit i ardhun prej Kavaje). Në shtrimjen e madhe të shumsave me **-ra** mund të ndihmojë edhe modeli i shumsave me **-a** ose forma e trajtës së pashqueme të emnave që dalin në temë me bashkëtingëlloren **r**, që siç dihet janë të shumtë (motër > **motra**; **hasër** > **hasra**, **lepër** > **lepra** etj.)

4) Nji çfaqje tjetër e analogjisë në shtrimjen e morfemave formëformonjëse të rotacizueme vërehet në format e pashtjellme të pjesores. Këtu asht fjala për shtrimjen e prapashtesave **-ur** (< **-un**) dhe **-r** tek disa pjesore, që ose kanë sot nji prapashtesë tjetër formëformonjëse, ose kanë pasë nji të tillë përpara.

Përgjithësisht trajtat, që rezultojnë nga ky përgjithësim analogjik, nuk gjinden jo vetëm në të folmet toske, që janë kufitare me të folmet kalimtare, por, me sa dimë ne, edhe në asnji toskënishte tjetër.

a) Prapashtesa **-ur** në disa raste u shtohet pjesoreve, që kanë pasë së pari prapashtesën **-m**: **pushtumur**, **bamur**, **dërmumur**, **pimur**, **pamur**, **qamur**. Këto trajta, që takohen rrallë, vihen re në ato të folme ku ekzistojnë edhe pjesoret me prapashtesën **-m**.

b) Disa folje të zgjedhimit të parë ose disa folje të parregullta e supletive, të cilat dalin në pjesore me prapashtesën **-në**, që ruhet e parotacizueme edhe në toskënisht, marrin analogjikisht prapashtesën **-ur**. Me prapangjijtjen e kësaj morfeme përftohen formacione që nuk i kanë toskët fqinjë: **lânur**, **qenur**, **thanur**, **zanur**, (shtrimja e **-ur-it** vërehet si në format e adjektivueme me nyjëzim të këtyne pjesoreve: e **(thanur**, ka pas **q n i zanur**, ashtu edhe në formën e pashtjellun të pas-kajores: ta çoj për **t'përzatur**).

c) Foljet, të cilave u mbaron tema me **-I**, **-II**, **-r**, **-rr**, kanë marrë analogjikisht prapashtesën formëformonjëse **-ur**, meqënëse prapashtesa **-ë** (në të vërtetë element i prapashtesës së herëshme **në** të reduktueme) tue u ndodhë në pozicion fundor ka ranë: **dalur**, **nelur**, **myllur**, **mshtjellur**, **varur**, **therur**, **thurur**, **thirrur**, **marrur** (krahaso edhe **dalë**, **mbyllë**, **varë**, etj. të toskëve fqinjë).

c) Përveç prapashtesës **-ur** me të cilën në këto të folme dalin rregullisht format e pjesoreve, që sosin me bashkëtingëllore në temë, shtrihet analogjikisht edhe prapashtesa **-r** tek foljet, që sosin në temë me zanore. Në të folmet e këtij grupi ndëgjoen: **msūr**, **djūr**, **afrūr**, **prūr**, **lërūr**, **rapūr**, **purūr**, **shkūr**.

Në trajtat e sipërme ne shofim **shtrimje** analogjike të prapashtesës **-r**, e cila asht karakteristike vetëm për jugun dhe përkundrazi nuk e

shofim si një element morfematik që këto të folme ta kenë të vetin për arësytet që pasojnë:

Së pari, trajtat e sipërme sosin në temë me zanoren e gjatë \bar{u} , që asht përfutue nga monoftongëzimi i diftongut **ue** (dhe vetëm të këtij diftongu²⁶). Pra tema e këtyne formacioneve asht temë e formës geqe.

Së dyti, një influencë e thjeshtë e **u-së** (< **ue**) të së folmes së Elbae shpjegon dot p.sh. sanit nuk **u**-në që gjejmë sot në temën e pjesoreve në Sulovë, sepse, përndryshe, këtu duhej të kishim edhe format e pjesoreve me prapashtesën **-m** të njohun në Elbasan dhe shumë të njohun në Shpat, që asht e folmja kufitare në veri të Sulovës. Pra e folmja e Sulovës do të huante nga fqinjët jo vetëm temën e pjesores por të gjithë formën e pjesores (me gjithë prapashtesën **-m**), sepse, siç thamë edhe ma sipër, format e pjesoreve me **-m** në Shpat janë mbizotnuese për grupin e foljeve të zgjedhimit të parë.

3) **Së treti**, temën e këtyne pjesoreve të tipit punūr, që gjejmë në të folmet e këtij grupi, tue përfshih edhe Sulovën, e shofim të vendit, kurse prapashtesën **-r** si element të jugut të shtrime analogjiksht, sepse marrim në konsideratë edhe pohimin e **M. Lambertzit**, i cili vëren «... se në kohën e emigracionit të stërgjyshënve të kolonistave tanë në shekullin XV-të, i ashtuquajtni monoftongëzim i gegënishtes ka qënë përhapë shumë ma larg nga jugu por në këto pesë shekujt e fundit qarku i zgjanimit të tij asht ngushtue prej diftongut që ka dalë prej ndonji qendër gjuhësore të Shqipnisë së Jugut dhe ashtu u shty përsëri kah veriu»²⁷).

Si përfundim pra ne jemi për rrugën: **shkue** > **shkū** > **shkūr** edhe jo për **shkuar** > **shkūr**.

Besojmë që prapashtesa jugore **-r** të jetë futë e të jetë përhapë në format e pjesores së foljeve të këtij zgjedhimi edhe për arësye të përdorimit të dendun të pjesoreve me **ur** për foljet me temë në bashkëtingëllore (megjithatë, këtu kemi një shtrimje të **-r-së** së modelit toskë **puunar**); këte e dëshmon fakti se prapashtesa **-r** aht shtri sidomos në ato folje, që dalin në temë me \bar{u} (< **ue**), e cila sëbashku me prapashtesën **-r** formon një kombinim që përkon tingëllisht me prapashtesën **-ur**: **mūr**, **djūr**, **afrūr**, **p.ūr**, **lērūr** etj. Prapashtesa **-r** e futun analogjiksht tek pjesoret e zgjedhimit të parë ruhet edhe në rastet kur këto pjesore adjektivohen: ar e **punūr**; grua e **marūr**, mosh e **kalūr** etj.

Grupi i dytë i të folmeve kalimtare.

Të shofim shtrimjen në thellësi të rotacizimit në grupin e dytë të të folmeve kalimtare.

Përsa i takon Bregdetit të Poshtëm të Kavajës, ne kemi thanë se këtu jetojnë paralelisht trajtat geqe të parotacizueme dhe toske të rotacizueme. Popullsia e këtij truelli asht e ardhun nga një krahinë toske, prandaj ata tani kanë marrëdhanie të dyfishta: me vendet nga kanë ar-

26) E. Çabej, «Fonetika historike e Shqipes» (dispensë) 1960 (Botim i II-të), f. 105.

27) M. Lambertz, «Dialektet lokale të shqiptarëve në provincat italiane të Campobasso-s dhe të Foggias (Molise)» «Arkivi i Institutit të Historisë e Gjuhësisë»

dhë bajnë krushqi si të krishtenë që janë, me veriorët gegë janë në marrëdhënie të vazhdueshme ekonomike (pazaret i bajnë kryesisht në Kavajë).

Trajtat e ndryshme, që jetojnë paralelisht, ne i kemi gjetë qoftë në subjekte të ndryshëm, qoftë tek i njejtë subjekt. Format që dalin ose jo me rotacizëm u takojnë pjesëve të ndryshme të ligjeratës: **Emnat: gjarpri** dhe **gjarpni**; **huri** dhe **hûni**; **përemna: njoëri** dhe **njana**; por ma tepër bien në sy format peremnore të rotacizueme: **atyre, këtyre; foljet: hyri** dhe **hÿni**, **mulû** dhe **mulûr**.

Në këto të folme gjejmë njëkohësisht forma shumdash të ndëtueme me mbaresat **-na** dhe **-ra: shira, vitra, vjeshtra, ujra**; gjithashtu edhe: **dryna, ynyrna, krojna, shtretna, ujna**; madje mbaresa **-na** shtrihet në ndonji rast edhe tek mbiemnat e substativueme: **t'mirnat**. Këtu gjejmë prapashtesën **-ir(ë)** (që në të vërtetë predominon) dhe variantin fonetik primar të saj (**in-ë**): **cektir, thatsir, trubullir, pjersir**, por edhe **turbullin**. Këtu ndigjohen njëkohësisht variantet toske e geqe të prapashtesës **-(ë)ni**, ndër të cilat ma i përhapun asht varianti **-(ë)ni: fushni, vjetërnî, mirni, toskni**, por edhe **toskëri**.

Përsa u përket formave të pjesoreve, tema e të cilave del në zanore, në këto të folme vërejmë: 1) Forma pjesoresh me prapashtesën **-r** jugore, 2) Forma pjesoresh pa prapashtesë, ashtu siç dalin në shumë të folme veriore; 3) Forma pjesoresh me prapashtesën **-m**, oë sot asht karakteristike vetëm për të folmet veriore: **luftur, njur, shur, shtur, prur, msur, mulur; prû, nalû fitû**. Prapashtesa **-m** takohet ma rrallë (kryesisht në format e pjesoreve të adjektivueme): **bam, t'penume, i shkatrumun**.

Edhe në të folmen e Bregdetit të Poshtëm të Kavajës prapashtesa **r** asht një shtrimje analogjike mbas pjesoreve që dalin pa prapashtesë. Ky mendim mbështetet me faktin se këtu ne gjejmë pjesore pa prapashtesë (**fitû**), që s'mund të vijë nga një «**fitua**» toske; për ma tepër kur ne konstatojmë në këte të folme fjalë dhe forma fjalësh të huajtura nga gegënishtja, siç asht p.sh. infinitivi perifrastik gegë **me + pjesore**, i cili ndeshet rëndom këtu; përmendim disa shembuj nga shumë të mundshëm: **me m'bor** yzmet; kur e hipën n'vapor **me e çur** atje ke burri... , **qo zu me qar**, qi kur **me e zgjesh** qo e âma n'darket **me fjetur** na i bjen ksaj gocës n'jatakt; qe nisur **me ardhur**; erdhën **me grabitur**, ke pa nonji t'mytur **me ikur** përpjet /i mytmi ikën taposht; **me e peshur** gjuhën e Elbasanit; **me u thar dy/ do thûsh**: u thân ftôjt, **me shkûr** në brek detit, donte **me i qitur** ca rop na puna atje, **me e dar** kshu / i thomi katër kurtarësh etj.

Pjesoret, të cilave u del tema me bashkëtingëllore, në këte të folme rrejnjë rregullisht prapashtesën formëformonjëse **-ur: gjetur, vulosur, ardhur**; po kështu edhe format e adjektivueme të pjesoreve: **i humur, e kapur**. Prapashtesën **-ur** e marrin analogjikisht edhe ato pjesore, që dalin në temë me **l, ll, r, rr: dalur, varur, nxjerrur**.

Në këte të folme kemi konstatue gjithashtu shtrimje analogjike të rotacizmit, ndër të tjera edhe analogji morfologjike, në shembujt që pasojnë: — do t'u shtjesh **h es qevet?** — i shtyra (= i shtiva), e **lyra** me **balt** (= e leva), t'i njiit durët / t'i **lyer** me **shiraz** (= t'i lyen); **ftua** > **fturi**; **nyri** (kamës), **thuri** (gjishtit) etj.

Grupi i tretë i të folmeve kalimtare.

Për këte grup të folmesh kalimtare, ku mbizotëjnë trajtat e paracizueme, do të ndalemi shkurtimisht në rastet ku jeton fenomeni i rotacizmit²³⁾. Duhet thanë se rotacizmi në këto tri të folme nuk shtrihet një-lloj; kështu p.sh. në Darsi të Peqinit trajtat e rotacizueme takohen shumë ma pak se në Dumre etj. Rotacizim në të folmet e këtij grupi gjejmë në këto raste kryesore:

1) Rotacizohet në disa raste **n** ndërzanore që asht pjesë e temës së emrave (kryesisht ndërrimi **n** < **r** ndodh në trajtën e pashqueme): **di-mër, drapër, emër, lakër, i krishter-i**; Në trajtën e shqueme **dimni, emni**.

2) Shumë herë mbaresa **-na** e shumsit në të folmet e këtij grupi takohet në variantin **-ra** të jugut: **Dumre: plehra, Darsi: punra; V. Myzeqesë: fshatra, gjōra**.

3) Del në formë të rotacizueme sufiksi **-(ë)ni**: **çunri, pleqëri, toskëri, gegëri**.

4) Në të folmet e Dumresë dhe V. Myzeqesë takohen disa forma foljore, përemnore e mbiemnore me **n** ndërzanore të rotacizueme: **bâori** (=bani); **jâri** (=njani), **târ** (=tanë); **t'gjàor**. Në Darsi të Peqinit këto trajta nuk i kemi takue.

5) Në këte grup të folmesh konstatohet një shtrimje shumë e madhe e prapashtesave formëformonjëse **-r, -ur**, tek format e pjesoreve:

a) Disa pjesore, që e riejnë akoma prapashtesën **-m**, kanë marrë në mënyrë suplementare prapashtesën **-ur**: (ta ket) **bamur**, (kishte) **çumur**, (â) **kthymur**.

b) Foljet që dalin në temë me zanoren **- (< ue)**, marrin analogjikisht prapashtesën **-r**: **fillur, jetur, shkurtur**.

c) Disa folje të zgjedhimit të parë ose disa folje të parregullta e supletive, në këto të folme, pas prapashtesës **-n**, marrin në mënyrë suplementare prapashtesën **-ur**: (ka) **qenur**, (kam) **zanur** (Dumre); (t'kam) **thanur** (Darsi); **qanur, zanur** (Ekstremit V. i Myzeqesë).

ç) Shtrimje të theksueme (sidomos në Dumre) të prapashtesës **-ur** ne vejmë në të format e pjesoreve, tema e të cilave del në bashkëtingëllore tue përfshi në këte rast edhe ato që dalin në **-l, -ll, r-, rr**: **hapur, çuditur, mushur, varur, marrur, myllur, jallur**.

d) Prapashtesa **-ur** e toskënishtes takohet edhe në format e infinitivit perifraztik gegë me + pjesore: dulën me **gjujtur**, kishin nis me **platur**, ra me **gjetur**.

§ 8. Rrugët e përfhtimit të rotacizmit në të folmet kalimtare.

Pasi vërejtëm shtrimjen gjeografike dhe shtrimjen në thellësi të rotacizmit në të folmet kalimtare, lind pyetja: asht rotacizmi në këto të folme një dukuni historike po aq e vjetër sa edhe në toskënisht apo asht çfaqje e mavonshme?

23) Këto të folme janë ba objekt studimi në punimet dialektore që pasojnë: **M.I. Çeliku** «Vërejtje mbi të folmen e Dumresë» Bulet. i Univ. Sht. Tiranës Nr. 2-3/1963; **M.I. Çeliku** »Informacion mbi të folmen e Peqinit» (e pabotueme); **J. Gjinari**: «Të folmet e Myzeqesë» Bulet. i Univers. Shtet. të Tiranës Nr. 4/1958.

Dihet se për toskënishten fenomeni i rotacizmit asht një inovacion i hershëm, që i përket periodës paraliterare të gjuhës²⁹.

Rotacizmi në të folmet kalimtare nuk na duket të jetë një çfaqje kaq e vjetër; përkundrazi këto fenomen e shohim si një çfaqje relativisht të vonë si rezultat të influencës direkte të toskënishtes, pavarësisht nga përhapja e madhe që ai ka sot.

Mendojmë kështu ndër të tjera për këto arësye:

1) Së pari, në pjesën më të madhe të të folmeve kalimtare gjejmë edhe sot trajta të tilla, tek të cilat manifestohen bashkarisht (në të njëjtën fjalë) nazaliteti i gegënishtes edhe rotacizmi i toskënishtes: **hûri, frëri, zâri, bâra, njâri**. Mirëpo «përndarja dialektore e sotme në gjuhën shqipe është kjo, që toskënishtja paraqet dukurinë e rotacizmit bashkë me mungesën e nazalizimit. Përkundrazi gegënishtja ka nazalizëm bashkë me mungesën e rotacizmit, në përgjithësi».³⁰

Atëherë si shpjegohet nazaliteti në trajtat tona të rotacizueme? Në qoftëse këto do të ishin trajta të rotacizueme së lashti, zanoret e theksueme të këtyne trajtave duhej të kishin humbë nazalizimin si edhe në toskënisht.

Nga ana tjetër nuk mund të mendohet se trajta të tilla të rotacizueme të kenë qenë në këto të folme së pari si në toskënisht pa zanore nazale dhe pastaj (d.m.th. në një kohë të mavonëshme) mbartësit e këtyne trajtave të huanin nazalitetin e gegënishtes me anën e kontakteve, të cilin e humbën një herë.

Nazaliteti i këtyne trajtave nuk mund të shpjegohet gjithashtu as me shtrirje analogjike, d.m.th. si nazalitet sekondar, për arësye se ky përgjithësim analogjik do të vërehej edhe në trajta si **fmiri, miri** etj., cse tek trajtat që kanë **a** të theksueme nazale, duhej shpjegue zanorja **â** për **ë**!

Ekzistenca e sotme e nazalitetit tek zanoret e theksueme në këto trajta të rotacizueme presupozon praninë e vonë të bashkëtingëlloreve nazale pas tyre, ciësinë e të cilave e kanë të tynen zanoret paraprise.

Nga këto që thamë rezulton se nazaliteti i zanoreve të theksueme në këto trajta në veçanti dhe në këto të folme në përgjithësi s'asht tjetër veçse tipar i mbrendëshëm i këtyne të folmeve, tipar i shtrësës arkaike të këtyne të folmeve, kurse ndërrimi $n > r$ asht relativisht i vonë. Pra në të folmet kalimtare duhet të kenë ekzistue deri vonë trajtat krejt geqe të vendit: **hûni, frëni, bâna** etj. Përsa u takon trajtave **huri, freri, shullari**, zanoret e theksueme të të cilave në të folmet kalimtare jugore nuk dalin nazale, duhet të shpjegohen me denazalizimin e trajtave koresponduese nazale, që gjinden në të folmet kalimtare veriore. Këto rezultate jugore (formacione të denazalizueme) përftohen për faktin se fenomeni i rotacizmit në esktrimet jugore asht krye ma herët (me që këto ndodhen ma afër të folmeve toske) tue u dobësue kështu dalëngadalë deri në zhdukjen e plotë në ndërgjegjen e folësve rrejta e uniformitetit në shqiptimin e zanores nazale, që tashma fonetikiisht në strukturën tingëllore të fjalës ka një pozicion krejt të ri. Dobësimi dhe zhdukja e nazalitetit tek të gjitha zanoret e theksueme bahet gradualisht e kjo shifet konkretisht me faktin se sa ma jugore të jenë të folmet kalimtare, aqë ma i dobët bëhet nazalizmi dhe tek **a**, e cila, pasi humb në një masë të

29) E. Çabej, «Fonetika historike e shqipes» (dispensë): 1960/ botim i II-të f. 115.

30) E. Çabej, «Fonetika... etj.» f. 102

konsiderueshme nazalitetin e tue qenë dhe pak labiale, i afrohet ë-së se aneksueme toske.

Në gegënisht, siç dihet, nazaliteti sot nuk asht tipar i kushtëzuem fonetik e kjo ka arësytet e veta; miafton të përmendim faktin se në disa forma flektive ridel bashkëtingëllorja nazale, e cila, si të thuesh, e ripertrin tiparin e nazalizmit, oë ka përvehtësue zanorja e theksueme. Në të folmet kalimtare veriore gjithashtu nazalizmi mundi të ruhej si tipar i pakushtëzuem fonetik nga një anë se nazalja **n**, në këto të folme si ma veriore që janë, u rotacizue ma vonë, nga ana tjetër trajtat me nazalizëm të plotë të të folmeve gegë fqinjë ndikojnë në rruetjen e këtij tipari.

Përkundrazi, nëqoftëse në Bregdetin e Poshtëm të Kavajës në këto formacione nuk ndihet nazalitet (**mulliri, peri, huri**), kjo asht një çfaqje krejt normale; e kjo për arsye se këtu nuk pritet nazalitet me që nuk kemi trajta të vendit (**pëni, hûni, mullini**) të rotacizueme ma vonë, por kemi trajta toske të mbartuna nga vetë folësit, të cilët janë këtu jo autoktonë.

2) Së dyti, ne mendojmë se rotacizmi si fenomen në të folmet kalimtare asht një çfaqje relativisht e vonë edhe për arsye se në këto të folme ky fenomen nuk ka të njëjtin aollikim si në toskënisht.

E me të vërtetë, siç e pamë, në këto të folme kemi një shtrimje analogjike të theksueme të rotacizmit, forma adaptimesh që janë shpërdorime të ligjëshmenisë së këtij fenomeni si dukuni historike e toskënishtes. Shpërdorime të tilla ose përgjithësime analogjike të tilla të paktën në toskënishten veriore, që asht fqinja ma e afërt e këtyne të folmeve, nuk vërehen.

Mendimi ynë për mënyrën e penetrimit dhe të shtrimjes së rotacizmit në të folmet kalimtare asht ky: mbartësit e të folmeve kalimtare që përdornin trajtat e vendit **hûni, frëni, bâna, njâni**, nën influencën e vazhdueshme të dialektit jugor, ranë në kontakt me trajtat e rotacizueme thjesht toske: **huri, freri, bëri, njëri**.

Në këte mënyrë janë përhapun, në fillim në zona kufitare jugore pastaj ma në veri, **dublete fonetike**. Nga përpjekja e këtyne dubleteve konkuruese lindën format e **kompromisit** (kontaminime); pra nga kontaminimi i formacionit (p.sh.) **bâna** dhe **bëra**, u përftue si rezultat **bâra** etj.

Siç dihet kontaminimi asht një fenomen mjaft i njoftun sidomos për të folmet kalimtare. Tue folë për fenomene analogë të gjermanishtes, për rajonin pranë lumit Rin **V.M. Zhirmunskij** na jep në të vërtetë përgjigje edhe për fenomenin tonë: «Shkaku i tanë këtyne lëvizjeve gjuhësore..., asht ekzistenca ma e madhe ose ma e vogël e marrëdhënies siuhësore intensive ndërmjet përfaqësuesvet të dialekteve fqinjë dhe vetë përhapja në zona kufitare të dubleteve fonetike, gramatikore dhe leksikore, si rezultat i hyrjes së fjalëve të veçanta edhe i formave nga dialekti fqinjë. Nga përpjekja e këtyne dubleteve konkuruese shpesh lindin format e **kompromisit** (kontaminime) si rezultat i përziemjes së maparëshme...³¹⁾.

31) **V. M. Zhirmunskij**, «Njemeckaja Dialektologia» f.119-120. Autori ndër të tjera bie edhe këte shembull si formë kompromisi në fushën e fonetikës: Për gjermanishten e veriut kemi: 1) **Zwolf** (12) dhe ate të jugut 2) **Twalf** (12). Në rajonin kufitar midis tyne, në një zonë të gjanë kemi dy format e kompromisit: **Zwaf** edhe **Twolf** etj.

Krijimi i formacioneve me kontaminim asht shoqnie pastaj me një përgjithësim shumë të madh analogjik.

Si përfundim ne mund të themi se rrugët e depërtimit dhe zhvillimit të rotacizmit në të folmet kalimtare janë: 1) Kontaminimet 2) Analogjizmi i theksuem dhe 3) Adaptimi që asht shpërdorim i zhvillimit historik të rotacizmit.

§ 9. Drejtimit ku fenomeni i rotacizmit mund të depërtojë ma lehtë në dialektin gegë.

Siç u tha edhe ma sipër, asht konstatue deri tani se disa të folme kalimtare kanë si bazë një shtresë të dukëshme gege; të folme të tilla ishin, sipas ndamjes që bamë ma sipër, ato të grupit të tretë: **Darsia e Peqiait, Ekstremi Verior i Myzeqesë, Dumreja.**

E në këto të folme fenomeni i rotacizmit, krahas dyzanorshit **ua**, asht ndër fenomenet toske që bien ma tepër në sy. E njëjta gja mund të thuhet edhe për të folme të tjera kalimtare.

Tue u mbështetë në të dhanat që kemi përkshkrue ma sipër, rezulton se rotacizmi, sikurse edhe dyzanorshi **ua**, mund të depërtojë ma lehtë në një të folme gege. Kjo shpjegohet me faktin se ky fenomen ka një shtrimje të madhe në thellësi (e gjejmë në shumë kategori fjalësh), pra ai mund të ndeshet shumë shpesh nga folësit gegë, kur këta bien në kontakte me toskët. Tjetër arsye që ndihmon në depërtimin e këtij fenomeni në gegënisht, asht edhe **dallueshmënia** e madhe e tij, pra ai bie në sy shumë shpejt e kjo favorizon huamarrjen e këtyne trajtave.

Rotacizmi vihet re sidomos në këto raste: 1) tek substantivat, sidomos kur ata janë të pashquem (**drapër, dimër**); 2) tek format e shumsit me mbaresat **-ra, -ër (gjëra, shira, vllëzër)**; 3) Tek emnat e prejardhun me prapashtesën **-(ë)ri (toskëri, pleqëri)**; 4) tek format përemnore (**këtyre, atyre, njari**) dhe 5) tek **participet** (ose tek emnat e prejardhun nga tema e participit me prapashtesën **-i: pasuri, dashuri**).

Përsa i përket rastit të fundit, duhet thanë se në formën e pjesoreve vërehet një shtrimje e madhe analogjike e prapashtesave formëformonjëse **-ur** e **-r**. Këto morfema futen gjithandej, qoftë në folje, që dalin në temë me bashkëtingëllore, qoftë tek ato që sosin në temë me zanore.

Shtrimjen e **-ur-it** në foljet, që sosin në temë me bashkëtingëllore, e favorizon fakti se këto folje, siç dihet, në shumë të folme gege i kanë humbë sot prapashtesat formëformonjëse **-un, -ë**.

Megjithate prapashtesa **-ur** shtrihet analogjikisht si një morfemë suplementare edhe në pjesore, që del së pari me një tjetër prapashtesë.

Prapashtesa **-r** shtrihet sidomos në ato folje, që dalin në temë me **ū (< ue): (e kam) shkrū r, shkuriū r, (ka) jetū r, kërlū r**.

Këte fenomen ne e vejmë re shpesh herë në shqipfolësit gegë, që mundohen të flasin toskënisht e sidomos tek ata të pashkolluemit (gegë), që në mënyrë të pavetëdijshme flasin toskënisht.

10. Konkluzione

I. Në pjesën e parë të këtij punimi ne trajtuem nocionin «e folme kalimtare» dhe si rezultat arritëm në këto përfundime:

1) Parshkuesit përgjithësisht kanë vu në dukje vetëm afërinë e dy dialekteve të shqipes dhe nuk janë marrë posaçërisht me të folmet ka-

limtare. Ndonjeni prej tyne ka përdorë me kuptimin ma të gjanë të fjalës nocionin e folme kalimtare: kanë konstatue në të majtë të lumit Shkumbin të folme me tipare të dialektit verior, por disa informacione që japin ata janë të pasakta. Së fundi, parshkuesit nuk japin asnji kriter për ta konsiderue një të folme kalimtare ose jo; gjithashtu nuk përcaktojnë kufijtë gjeografikë dhe përhapjen e këtyne të folmeve.

2) Ndryshe nga parshkuesit ne nocionin «e folme kalimtare» e përdorim me një kuptim ma të ngushtë: E folme kalimtare, sipas nesh, asht ajo e folme, në të cilën bashkëjetojnë të paktën një **tipar i randësishëm** i gegënishtes edhe një **tipar i randësishëm** i toskënishtes.

3) Ne konsiderojmë ekzistencën e rotacizmit dhe nazalizmit në një të folme si kriter për ta quejtë një të folme kalimtare.

4) Ne jemi mundue të precizojmë shtrimjen e të folmeve kalimtare të gjuhës shqipe tue tregue se cilat janë konkretisht të folmet kalimtare kryesisht në të majtë dhe për ndonji rast në të djathtë të lumit Shkumbin.

5) Përsa i përket problemit të formimit të të folmeve kalimtare, ne merdojmë se për disa të folme baza fillestare e të folmes ka qenë baza veriore të cilës ma vonë i u mbishtresuen tipare jugore, përkundrazi në ndonji rast tjetër baza fillestare ka qenë baza jugore, të cilës ma vonë i u mbishtresuen tipare veriore.

II. Në pjesën e dytë të këtij punimi ne u morëm me përshkrimin e fenomenit të rotacizmit në të folmet kalimtare, tue e shikue këte fenomen krahas me nazalizmin, e si rezultat erdhëm në këto përfundime:

1) Rotacizmi e nazalizmi janë dukuni e të gjitha të folmeve kalimtare. Nazalizmi në të folmet kalimtare jugore vjen e dobësohet ndër-sa rotacizmi në të folmet kalimtare veriore takohet ma rrallë.

2) Zonat kalimtare, përsa i takon përhapjes së këtij fenomeni, ndahen në tre grupe: a) Zona ku fenomeni i rotacizmit jeton pothuajse plotësisht; b) Zona ku trajtat e rotacizueme dhe të parotacizueme jetojnë pothuajse barabar, në mënyrë paralele; c) Zona ku mbizotnojnë trajtat e parotacizueme. Përshkrimin e kemi ba pikërisht sipas kësaj ndamjeje.

3) Tue u marrë me shtrimjen në thellësi të fenomenit të rotacizmit ne konstatuem, sidomos në grupin e parë të të folmeve kalimtare, se ky fenomen, ndryshe nga zhvillimi i tij në dialektin jugor, ka një shtrimje analogjike të theksueme (ndër të tjera: analogji morfologjike, adaptime).

4) Së fundi, ne rotacizmin në shumicën e të folmeve kalimtare nuk e shofim aq të vjetër sa edhe në dialektin jugor; përkundrazi, këte fenomen ne e shofim si një çfaqje relativisht të vonë si rezultat të influencës direkte të toskënishtes.

Mendimi ynë për mënyrën e penetrimit dhe të shtrimjes së rotacizmit në të folmet kalimtare asht ky: si rezultat të dubleteve fonetike konkurrese veriore e jugore u përfutuen në këto të folme, së pari në ato jugoret e pastaj tek të tjerat, forma kontaminimesh, të cilat u shoqnuen pastaj me një përgjithësim shumë të madh analogjik.

R é s u m é

LE RHOTACISME CHEZ LES PARLERS TRANSITOIRES
DE L'ALBANAIS

Dans la première partie de ce travail, l'auteur a délimité la notion «Parler transitoire». Ses conclusions sont les suivantes:

1) Les auteurs antérieurs ont fait ressortir, en lignes générales, le seul voisinage entre les deux dialectes de l'albanais: ils ne se sont pas occupés spécialement des parlers transitoires. Quelqu'un de ceux-ci a employé, mais dans une acception beaucoup plus large, la notion de parler transitoire: on a constaté à gauche du cours du Shkumbin des parlers offrant les traits du dialecte septentrional, mais les quelques informations qu'on donne à ce sujet pèchent d'inexactitudes. Enfin les auteurs antérieurs ne déterminent aucun critérium permettant de considérer un parler transitoire ou non, ils n'en font non plus la démarcation des frontières géographiques de ces parlers.

2) A la différence de ces auteurs, Çeliku emploie dans une acception plus étroite la notion «parler transitoire». Un parler transitoire, selon lui, est celui chez lequel coexistent, au moins un trait important du guèque et un trait important du tosqe.

3) L'auteur considère comme un critérium permettant d'appeler un parler transitoire l'existence du rhotacisme et du nasalisme.

4) L'auteur a voulu établir la démarcation de l'étendue des parlers transitoires en albanais, en montrant en fait quels sont les parlers transitoires notamment à gauche du cours du Shkumbin ou, dans quelque cas, également à droite de ce cours.

5) Pour ce qui est de la question de la formation de ces parlers transitoires, l'auteur est d'avis que pour certains parlers, la base originelle a été celle septentrionale, à laquelle vinrent s'ajouter, comme une sur-couche, des traits méridionaux; au contraire, dans d'autres cas, la base originelle a été celle méridionale, à laquelle sont venus s'ajouter, toujours comme une sur-couche, des traits septentrionaux.

Dans la deuxième partie de son travail, Çeliku a décrit le phénomène du rhotacisme chez les parlers transitoires, en regardant ce phénomène en même temps que la nasalisation, et comme résultat il est venu aux conclusions suivantes:

1) Le rhotacisme et la nasalisation sont des manifestations de tous les parlers transitoires. La nasalisation chez les parlers transitoires méridionaux vient à s'affaiblir, tandis que la rhotacisation chez les parlers transitoires septentrionaux n'est rencontrée que plus rarement.

2) Les aires transitoires, pour ce qui est de la diffusion de ce phénomène, se divisent en trois groupes: a) Aires où le phénomène de rhotacisation vit la quasi-totalité; b) aires où les formes rhotacisées ou non-rhotacisées vivent presque à la même échelle, parallèlement; c) aires où prédominent les formes non-rhotacisées. La

description faite par l'auteur est réalisée précisément d'après cette division.

3) Considérant l'étendue en profondeur du phénomène de rhotacisation, il a constaté que, notamment chez le premier groupe des parlers transitoires, ce phénomène, à différence de son développement chez le dialecte méridional, a une étendue analogue marquée (dans cet ordre sont à considérer les analogies, morphologiques, les adaptations).

4) Enfin, la rhotacisation des parlers transitoires n'est pas considérée par l'auteur aussi ancienne que chez le dialecte méridional; au contraire, ce phénomène est une manifestation relativement tardive, à la suite de l'influence directe du dialecte tosqe.

Sur la manière de pénétration et de l'extension du rhotacisme dans les parlers transitoires, l'auteur est de l'avis qu'elle est le résultat des doublets phonétiques concourants septentrionaux et méridionaux qui ont provoqué dans ces parlers, premièrement chez ceux méridionaux, ensuite chez les autres, des formes de contamination, auxquelles a fait suite, une grande généralisation analogique.

